



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë/Datum/Date:	16.02.2024
Për/Za/To:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga/Od/From:	Shkelzen Hajdini – Drejtor i DSHPS –së
Lënda/Subjecat/Subject:	Raport Mujor – Janar 2025

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur ju lutem gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën 01.01.2025 deri 30.01.2025.

RAPORT MUJOR PËR MUAJIN JANAR 2025

1. Përmbledhje ekzekutive

Viti 2025 ka filluar mirë edhe pse edhe muaji Janar është përcjellë me një numër më të madh të pacientëve si pasojë e gripit sezonal. Mirëpo, falë mobilizimit të personelit shëndetësor dhe planifikimit të mirë dhe me kohë, kjo rritje e numrit të pacientëve në këtë muaj është menaxhuar mirë dhe nuk na ndikuar në cilësinë e shërbimeve.

Megjithatë, vazhdon të jetë i lartë numri i infuzioneve dhe injeksioneve në trajtimin e pacientëve, si dhe ngarkesa në laborator dhe radiografi.

Këtë vit e kemi filluar duke rrumbullakuar përpjekjet tona dhe duke adresuar në tërësi objektivin strategjik krijimin e kushteve infrastrukturore për implementim të plotë të mjekësisë familjare respektivisht zoonimit, me theks të veçantë riorganizimin e ordinancave brenda QKMF-së, QMF në Gadime dhe QMF në Janjevë. Këto përmirësime të dukshme infrastrukturore kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në organizimin më të mirë të punës, përmirësimin e kushteve për mjekët dhe infermierët si dhe krijimin e mundësive për ofrim të shërbimeve më kualitative mjekësore.

Shërbimi i paliativit është zgjeruar me staf dhe është rregulluar orari i këtij shërbimi duke kaluar në dy ndërrime nga ora 07:00 deri në ora 23:00, edhe gjatë ditëve të vikendeve.

Punimet në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit kanë vazhduar edhe në vitin 2025.

Stomatologjia është duke funksionuar në objektin e maternitetit ndërsa rëntgeni në katin e dytë të objektit kryesor të QKMF-së.

2. Punët dhe aktivitetet e realizuara, bazuar në Planin e Punës së DHSPS-së për vitin 2024

Në fillim të këtij muaji kemi hartuar dhe dorëzuar Planin e Punës për vitin 2025. Në këtë plan kemi vendosur objektiva strategjike specifike dhe reale, të matshme dhe të realizueshme me afatet kohore të përcaktuara. Më tutje, secilën specifikë e kemi zbërthyer në aktivitetet më të rëndësishme duke kostuar secilin aktivitet.

Po ashtu, për zyrën e Kryetarit të Komunës së Lipjanit kemi përgatitur Raportin Vjetor për vitin 2024 në të cilin raport kemi pasqyruar punën e institucioneve shëndetësore të KPSH-së në Komunën e Lipjanit, punën e Qendrës për Punë Sociale, Shtëpisë me Bazë në Komunitet si dhe punën e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Dhoma për promovim dhe edukim shëndetësor (këshillimorja) është zgjeruar dhe është plotësuar me staf. Katër infermiere kanë ofruar shërbimet e kujdesit të integruar për pacientët geriatrik 65+ me sëmundje kronike jo ngjitëse si diabeti, hipertension, astma etj.

Në këtë muaj, kemi bërë planifikimin e nevojave për material laboratorik me qëllim të ruajtjes së nivelit të shërbimeve laboratorike dhe sigurimin e qëndrueshmërisë në ofrimin e 43 analizave.

Furnizimi me barna dhe material mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë i pjesshëm. Jemi përcjellë me mungesë të terapisë orale dhe disa lloje të barnave anti hipertensive.

3. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) gjatë muajit Janar janë kryer 51961 vizita dhe shërbime shëndetësore.

Stafi mjekësorë	Niveli i arsimimit	Meshkuj	Femra	Numri i punëtorëve gjithsej
Specialist të Mjekësisë Familjare	Superior/Specializim nga mjekësia familjare 26	13	13	26
Mjekë të Përgjithshëm	Superior/Master i mjekësisë së Përgjithshme 20	11	9	20
Doktor i Stomatologjisë	Superior/Master i Stomatologjisë 10	5	5	10
Specialist Radiolog	Superior/Specializim në Radiologji 1	1	0	1
Specialist i Pediatri	Superior/Specializim në Pediatri 1	1	0	1
Specialist Gjinekolog-Obstetër	Superior/Specializim në Gjinekologji me Obstetrikë 2	2	0	2
Specialist i Biokimisë	Superior/Specializim në Biokimi-Klinike 1	1	0	1
Teknik Laborant mjekësorë	Bachelor-4, Shkolla e mesme - 8	8	4	12
Infermier/e	Shkolla e mesme= 84 Bachelor=29	17	96	113
Mami	Shkolla e mesme-12	0	12	12
Teknik të stomatologjisë	Shkolla e mesme-6	2	3	5
Teknik të radiologjisë	Shkolla e mesme-3	2	2	4
Punëtor teknik	Shkolla e mesme-19, shkolla e mesme e ulet-4	12	11	23

Punëtor në administratë	Shkollim superior-4 Shkollim i mesëm-4	7	1	8
Numri i punësuarve nga komuniteti jo shumice	Shkolla e mesme-3	1	2	3
Numri i punëtorëve me nevoja të veçanta	Shkolla Filllore- 2 Shkolla e mesme-2	3	1	4
Gjithsej numri i punëtorëve	Shkollim superior =64, Shkollim bachelor =33, Shkollimi i mesëm=137, Shkollimi i mesëm i ulët = 4	90	148	238

Janar 2025-Vizitat Mjekësore

1	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në QKMF	11430
2	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në Punte	5580
3	Vizita mjekësore Pediatrie	514
4	Vizita mjekësore Gjinekologjike	308
5	Vizita mjekësore Stomatologjike	741
6	Vizita mjekësore Pulmologjike	58
7	Vizita mjekësore Emergjente	5136
8	Vizita në kujdesin Paliative	489
9	Total	24256

Janar 2025- Shërbime Shëndetësore

1	Injeksione	10784
2	Infuzione	5616
3	Pastrim lidhje	1368
4	RTG	465
5	Laborator	2947
6	Lindje	0
7	Largim i Penjve	74
8	Imobilizime të	37
9	Oksigjenoterapi	107
10	EKG	458
11	Mamografi	47
12	USG	146
13	Vizita Shtëpiake me Autoambulancë	90
14	Transport me Autoambulancë	65
15	Vizita në Stacionin Policor	0
16	Vizita në Qendrën e azilit -Magure	0

17	Vizita në qendrën e paraburgimit	18
18	Rrahje	3
19	Këmbësor i lënduar me automjet	0
20	Konstatim vdekje	13
21	Plagosje me armë zjarri	0
22	Thumbim i rrigrave	0
23	Aksidente trafiku	20
24	Dhunë familjare	0
25	Exitus letalis / mortus ad latae	0
26	Këshillimorja	3427
27	Vakcina	580
28	Vaksina për COVID	0
29	Shërbime stomatologjike	1241
30	Referime	0
31	Inhalime	87
32	Vizita infermiere gjinekologjike	18
33	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet	20
34	Klasa për nëna	74
33	Gjithsej shërbime	27705

4. Qendra për Punë Sociale QPS

Tabela 1. Shërbimi social: Shërbimet dhe klientët.

<i>Klientët</i>	<i>Numri i rasteve</i>	<i>Shërbimet</i>	<i>Numri i rasteve</i>
<i>Klientë të cilët kërkojnë fëmijë për strehim familjar</i>	1	<i>Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin.</i>	6
<i>Të mitur në konflikt me ligjin.</i>	6	<i>Këshillim për bashkëshortet në martesë dhe psiko-soc.</i>	5
<i>Klient në nevojë për këshillime martesore.</i>		<i>Besimi i fëmijëve dhe mbikëqyrja e vizitave Prindërore.</i>	5
<i>Fëmijë me sjellje asociale</i>	8	<i>Intervenim i Viktimave.</i>	16
<i>Martesa e të miturve që dëshirojnë të hyjnë në martesë.</i>		<i>Shërbime për fëmijët me sjellje asocial.</i>	8
<i>Viktimat e dhunës në familje.</i>	6	<i>Shërbime. për fëmijë me aftësi të kufizuara</i>	161
<i>Viktima të vendosura në strehimore</i>		<i>Sanim i marrëdhënieve familjare</i>	5

Klient me aftësi të kufizuara- Fëmijë		Këshilla Psiko-Sociale	5
Fëmijë të keqtrajtuar dhe abuzuar.	2	Intervenime gjatë orarit të Kujdestarisë	5
Fëmijë të keqtrajtuar-abuzuar (lënë pas dore)		Intervenime te përgjithshme	0
Klient tjerë në nevojë për shërbime	96	Përfaqësues të përkohshëm.	6
Nr. i Përgjithshëm i Klientëve.	122	Nr. i Përgjithshëm i Shërbimeve	667

Tabela 2. Shërbimet e asistencës sociale.

	Aktivitetet	Kategoria 1	Kategoria 2	Gjithsej
APLIKIMI	1.Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë.	5	6	11
	Sa prej tyre janë të aprovuara.	5	6	11
	Sa janë në shqyrtim .	1	2	3
	Sa prej tyre janë të refuzuara .	0	0	0
RIAPLIKIMI	2. Numri i rasteve të larguara për mos ri-aplikim.	4	3	7
	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar.	38	47	85
	2.2 Numri i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacioni.	3	4	7
VERIFIKIMI	3.Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuara.	38	47	85
	Sa prej tyre janë aprovuar Koliko od njih je odobreno.	32	41	73
	Sa prej tyre janë. refuzuar/çregjistruar	6	6	12
KOM. MJEKSOR	4. Numri i rasteve të dërguara. në Komision Mjekësor (KM) .	63	0	63
	Numri i rasteve të aprovuara nga KM.	63	0	63

	<i>Numri i rasteve të refuzuara nga KM.</i>	0	0	0
	<i>Numri i rasteve të kthya nga KM për kompletim dokumentacioni .</i>	0	0	0
	3.Numri i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit .	1	0	1
	<i>A. Në shkallë të parë(I).</i>	0	0	0
	<i>B. Në shkallë të dytë(II)</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave të aprovuara.</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave të refuzuara.</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave në shqyrtim.</i>	0	0	0
	<i>Kontestet në Gjykata.</i>	0	0	0
	<i>a)Kontestet të pranuara.</i>	0	0	0
	<i>b)Konteste të refuzuara.</i>	0	0	0

5. Shtëpia me Bazë në Komunitet

Gjendja shëndetësore e rezidentëve gjatë këtij muaji në përgjithësi ka qenë e mirë.

6. Investimet Kapitale

Projekti Ndërtimi i Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit është duke vazhduar.

7. Vështirësitë dhe sfidat

- Furnizimi i pjesshëm me barna dhe materiale mjekësore nga Ministria e Shëndetësisë,
- Numri i madh i pacienteve në QKMF dhe në shërbimin e Urgjencës për shkak të gripit sezonal.

8. Planifikimi për muajin Shkurt 2025

- Zbatimi i planit të veprimit për vitin 2025 dhe implementimi i shërbimeve të integruara,
- Vazhdimi i EVP-së me staf mjekësor,
- Takime pune me AQH dhe IHS nga Zvicra (Me 12.02.2025 dhe 14.02.2025).